



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Pogradec, më 24.04.2026

VENDIM

Nr. 11 Datë 24 /04 /2026

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHES

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Ejnte , më datë 30.04.2026, ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec, zhvillohet mbledhja e rradhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr.40, datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 30.03.2026.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 30.03.2026.
5. **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Mars 2026.
6. **Projekt – Vendim:** Për “Detajimin dhe përdorimin e fondit të Kushtëzuar për mbrojtjen civile 2026”
7. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e Planit Lokal të veprimit për Barazi , përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Pogradec (2026-2030)
8. **Projekt – Vendim:** Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101, datë 31.10.2025 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec për vitin 2026”
9. **Projekt – Vendim:** Për dhënie ndihmë financiare për znj.E.P.
10. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e zgjatjes të periudhës së ngrohjes në institucionet arsimore të Bashkisë Pogradec.

11. **Projekt – Vendim:**Për miratimin e distancave sipas rrugëve të reja të transportit rrugor rrethqytetës të udhëtarëve dhe linjave të transportit për punonjësit arsimorë, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve të Bashkisë Pogradec, si dhe miratimin e linjës së re Lagjia Lazishtë Velcan- Shkolla Bishnicë për transport nxënës.
12. **Projekt – Vendim:**Për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga shoqëria “KRWM” SH.A tek shoqëria “Agjencia Kombëtare e ekonomisë të mbetjeve” sha.
13. **Projekt – Vendim:**Për miratimin e dhënies me qira, për vendosjen antene të telefonisë të lëvizshme në favor të kompanive one Albania SH.A në sipërfaqe, 160 m2 në pasurinë 665 zk 2042 Kalivac, Trebinjë dhe Vodafone Albania SH.A sipërfaqen 100 m2 në pasurinë 213/6 zk 3753 Vërrë, Proptisht.
14. **Projekt – Vendim:**Për disa shtesa dhe ndryshime mbi mënyrën e organiizimit dhe funksionimit të shërbimit taksi në Bashkinë Pogradec.
15. **Projekt – Vendim:**Për rishqyrtimin e tarifave të administrimit për ndërtesat që do të administrohen nga Shoqëria Pogradec Invest shpk.
16. **Projekt – Vendim:**Për rishqyrtimin e tarifave të parkimeve që do të aplikojë shoqëria Pogradeci Invest shpk, për vitin 2026.
17. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 8 Ha e 5543 m2 ,e ndodhur në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qira.
18. **Informacion nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës në lidhje me punën e kryer gjatë periudhës Janar-Prill 2026, sfidat, sukseset dhe planet në vazhdim për vitin 2026.**
19. Të tjera.

Ngarkohet Sekretarja e Këshillit , në mungesë Kryetarja e Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes në mediat sociale,lokale dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës për cdo këshilltar, te kryetari I Bashkisë Pogradec, Deputetët e Bashkisë Pogradec dhe personat apo dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te kryetari I Bashkisë Pogradec.

PËR KRYESINË E KËSHILLIT

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI